

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**PYJE**

**Niveli I**

**Kodi: S-I-18**

Miratoi:

**MINISTRI**

**Tiranë, 2018**

## **Përmbajtja**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor "Pyje", niveli I.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Pyje", niveli I**

1. Kërkesat e pranimet të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin "Pyje" niveli I.
2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Pyje", niveli I
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Pyje", niveli I.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Pyje", niveli I.

**III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin "Pyje", niveli I.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Pyje", niveli I.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I, është “*zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në veprimtari profesionale që lidhen me drejtimin e pyjeve*”. Zhvillimi te nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset bashkëkohore e të perspektivës në fushën e ekonomi-biznesit që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Pyje” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MFE përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tyre dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tyre dhe të shfaqin gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojnë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I**

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, **niveli I**, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të identifikojë llojshmërinë e drurëve dhe shkurreve pyjorë, bimëve eterovajore, mjeksore e industriale që rriten në mënyre spontane dhe të kultivuar në vendin tonë.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet ndihmëse dhe mekanizmat në operacionet e prodhimit të materialit drusor në pyll.
- Të respektojë standardet e asortimentëve që prodhohen në pyll.
- Të kryejë transportin ajror me teleferik, me një litar dhe me 2 litarë ose zbritësat e thjeshtë.
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të lexojë dhe interpretojë skema të thjeshta të punimeve në pyje.
- Të realizojë nxjerrjen e farave nga frutat e drurëve pyjorë.
- Të përgatisë tokën për mbjellje në fidanishte dhe të mbjellë atë.
- Të realizojë shërbime mbas mbjelljes së farave.
- Të realizojë hapje të gropave dhe të mbjellë fidana.
- Të identifikojë dhe të njohë llojet kryesore pyjorë të vendit tonë.
- Të ndihmojë në kryerjen e punimeve të sistemimeve malore dhe rrugëve pyjore.
- Të përzgjedhë kulturat për krijimin e kopshtit të shtëpisë (fermës) dhe kombinimin e tyre në varesi të kushteve ekologjike si dhe traditës së zonës .
- Të përcaktojë hartën e bimësisë në pyll si dhe karakteristikat e tyre.
- Të kryejë prerje kulturore në pyje.
- Të organizojë dhe të planifikojë zbatimin e prerjeve kulturore dhe kryesore në pyje.
- Të përdorë hartat në terren si kusht i domosdoshëm për orientimin në pyll.
- Të realizojë skica dhe vizatime teknike bazuar në njohuritë e përgjithëshme që ka marrë nxënësi.
- Të marrë një sipërfaqe provë si pikë që përfaqëson kushtet mesatare të parcelës.
- Të marrë të dhëna në terren që shërbejnë për hartimin e nje plani mbarështrimi.
- Të përdorë dhe të marrë të dhëna nga një plan mbarështrimi.
- Të përdorë mjete dhe metoda për uljen e veprimit të dëmtuesve në pyll.
- Të kryejë punime për mbrojtjen e pyllit nga zjarri.

- Të përdorë mjetet matëse të thjeshta që përdoren në pyje, si metër shirit, nivelues teodolit,
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës në punimet e shfrytëzimit në pyje.
- Të kryejë punime të tilla si pastrime hapje rrugësh, pastrime degësh me vegla dore dhe me mjete elektrike.
- Të përdorë hartën dhe të dijë të orientohet në pyll nëpërmjet busullës.
- Të përcaktojë moshën e shfrytëzueshmërisë dhe damkosjen e tyre.
- Të realizojë parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet mbarështrimi pyjor..
- Të përcaktojë karakteristikat dendrometrike të grumbullit.
- Të përcaktojë diametrin mesatar dhe lartësinë mesatare duke përdorur mjetet matëse.
- Të njohë faunën e florën e Shqipërisë si dhe të mbrojë ato.
- Të interpretojë dobinë dhe vlerat e llojshmërisë së faunës.
- Të klasifikojë kafshët e dobishme dhe të dëmshme të pyllit.
- Të kuptojë strukturën e ekosistemit të një pylli , dinamikën dhe proceset që ndodhin.
- Të përcaktojë rritjet e grumbullit pyjor.
- Të njohë metodat e mbrojtjes së pyjeve, pesticidet kryesore si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar në këtë drejtim profesional.

Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punonjës gjysëm i kualifikuar në veprimtaritë profesionale që lidhen me zhvillimin, mbarështimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të pyjeve, mbrojtjen e pyjeve së bashku me florën e faunën e egër që rriten në to, si dhe shfrytëzimin e pyjeve, duke nxitur kështu dhe zhvillimin e agropylltarisë dhe turizmit pyjor në përgjithësi.

Përsa i përket arsimimit të mëtejshëm, nxënësi ka mundësi të vazhdojë studimet e mëtejshme në nivelin III të arsimit profesional, në një prej profileve dyvjeçare të drejtimit mësimor “Pyje”, si dhe fiton ”Maturën shtetërore profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmës.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I

Plani mësimor për drejtimin “Pyje” Niveli I				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Niveli I	
			Orët javore/vjetore	
			Klasa 10	Klasa 11
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	14/15 (504/ 540)	10/11 (340/ 374)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Matematikë	2	2

6		Fizikë	2	-
7		Kimi	-	2
8		Shkenca sociale	2	-
9		Histori	-	1
10		Gjeografi	1	-
11		TIK	1	-
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale (Gjithsej)</b>	<b>10(360)</b>	<b>8 (272)</b>
1	L-01-136-17	Vizatim teknik	1	-
2	L-25-137-09	Botanikë e fiziologji e bimëve	2	-
3	L-25-138-09	Pedologji pyjore	1	-
4	L-25-139-17	Mekanizim pyjor	1	-
5	L-25-140-17	Dendrologji	2	-
6	L-25-141-09	Sistemime malore	1	-
7	L-25-142-09	Fidanishte pyjore	2	-
8	L-25-143-09	Biologji e kafshëve të pyllit	-	1
9	L-25-144-17	Studim i drurit	-	1
10	L-25-145-17	Rrugët pyjore	-	1
11	L-25-146-17	Silvikulturë	-	2
12	L-25-147-09	Dendrometri	-	2
13	L-25-452-17	Mbrojtja e pyjeve	-	1
<b>C.</b>		<b>Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)</b>	<b>5 (180)</b>	<b>7 (238)</b>
1	M-25-347-09	Proçeset e punës në fidanishte.	36	-
2	M-25-348-09	Punimet në pyllzimet artificiale.	36	-
3	M-25-349-09	Mbledhja e llojeve pyjore.	36	-
4	M-25-350-09	Mbrojtja e pyjeve dhe drurëve.	36	-
5	M-25-351-10	Punimet përgatitore për shfrytëzimin e pyjeve	36	-
6	M-25-352-11	Proçeset e matjeve të ndryshme ne pyje.	-	33
7	M-25-353-10	Ndërtime gardhesh dhe gabionesh në sistemime malore	-	36
8	M-25-354-10	Punimet në mirëmbajtjen e rrugëve pyjore.	-	36
9	M-25-355-11	Transporti materialit drusor me krahë dhe kafshë	-	33
10	M-25-356-11	Punimet në pyjet e degraduara të lisit	-	34
11	M-25-363-09	Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve bimore jo drusore.	-	33
12	M-25-358-11	Kultivimi i bimëve eterovajore	-	33
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)</b>	<b>1 (36)</b>	<b>2 (68)</b>
1	M-25-359-09	Krasitja e drurëve dekorativë.	36	-
2	M-25-360-09	Përcaktimi morfologjik i tokave.	36	-
3	M-25-361-09	Trajtimi i shëlgishteve për prodhim thupre	-	34
4	M-25-362-09	Punime për krijimin e lulishteve të vogla.	-	34
5	M-25-357-11	Punimet në rritjen artificiale të shpendëve	-	34
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31 (1080/1116)</b>	<b>27/28 (918/952)</b>

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 11 viti shkollor ka gjithësej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 1 javë për provimin e teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Gjatë tërë shkollimit dhe specializimit të tij, do të kihet parasysh se ekonomia e vendit nuk është e shkëputur nga ajo ndërkombëtare dhe se për më tepër në ditët tona marrëdhëniet ndërkombëtare bëhen gjithnjë e më intensive, sidomos me rënien e kufijve ndërmjet gjithnjë e më shumë vendeve evropiane, drejt të cilave synon dhe Shqipëria.

Sidoqoftë, funksionet dhe detyrat e tij konsistojnë kryesisht në planin zbatues dhe, më pak, në atë vendim-marrës dhe menaxhues të nivelit të lartë, gjë që kushtëzohet nga niveli i këtij arsimit profesional.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “Pyje”, **niveli I**.

Mësuesit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format

bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Pyje”.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me **nota** (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Pyje”, niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e pyjeve, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Pyje”, niveli I**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Pyje”, niveli I, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I.



## VII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Vizatim teknik” (L-01-136-17). Kl. 10 – 36 orë

#### • Synimet e lëndës “Vizatim teknik”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatim teknik.”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë dhe qëllimin e vizatimit teknik.
- Të përzgjedhin dhe përdorin materialet, veglat dhe pajisjet për skicat dhe vizatimet teknike të thjeshta.
- Të kryejnë vizatime të thjeshta me dorë të lirë.
- Të zbatojnë standardet ndërkombëtare të vizatimit teknik.
- Të lexojnë dhe përdorin shkrimin teknik.
- Të përcaktojnë standartin shtetëror STASH 83-83
- Të zbatojnë ndërtimet gjeometrike kryesore .
- Të përshkruajnë llojet e projeksioneve dhe të paraqesin projeksione ortogonale të thjeshta.
- Të vizatojnë detale të ndryshme duke vendosur përmasat.
- Të zbatojnë shkallët e vizatimit në vizatimet teknike.
- Të vizatojnë skicat e modeleve dhe të lexojnë ato.
- Të shpjegojnë vizatime me prerje dhe seksione .
- Të vizatojnë projeksione ortogonale dhe aksonometrike të trupave gjeometrikë.
- Të vizatojnë hapjen e sipërfaqeve të trupave gjeometrike .
- Të vizatojnë filetat, paraqitjen e tyre në vizatim.
- Të skicojnë vizatime të thjeshta përmbledhëse.
- Të vizatojnë planin e përgjithshëm të një zonë si dhe planimetrinë e një ndërtese të thjeshtë.

#### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatim teknik”, kl. 10 - 36 orë

<b>Tema 1</b>	Vizatimi teknik dhe fushat e tij të përdorimit	1 orë
<b>Tema 2</b>	Materialet,vijat dhe skicimi i tyre	4 orë
<b>Tema 3</b>	Materialet, veglat, pajisjet,formatet dhe vijat e vizatimit teknik	3 orë
<b>Tema 4</b>	Ndërtimet kryesore gjeometrike	4 orë
<b>Tema 5</b>	Shkrimi teknik .	2 orë
<b>Tema 6</b>	Paraqitja me disa rrafshe.	4 orë
<b>Tema 7</b>	Vendosja e përmasave	2 orë
<b>Tema 8</b>	Paraqitjet me prerje	3orë
<b>Tema 9</b>	Paraqitja aksonometrike	3 orë
<b>Tema 10`</b>	Hapja e sipërfaqeve të trupave gjeometrike .	2 orë
<b>Tema 11</b>	Vizatimet e punës të detaleve	2 orë
<b>Tema 12</b>	Vizatimet përmbledhëse	2 orë
<b>Tema 13</b>	Vizatimet e ndërtimit	4 orë

## 2. Lënda “Botanikë dhe fiziologji e bimëve”, (L-25-137-09), Kl. 10 - 72 orë

### • Synimet e lëndës “Botanikë dhe fiziologji e bimëve”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Botanikë dhe fiziologji e bimëve .”kl. 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e lëndës ”Botanikë dhe fiziologji e bimëve”
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe organet e qelizës.
- Të kryejnë vrojtimin në mikroskop të qelizës.
- Të përshkruajnë indet bimore.
- Të tregojnë funksionet e rrënjës.
- Të shpjegojnë funksionet e kërcellit, format dhe ndërtimin e tij
- Të përshkruajnë ndërtimin e rrathëve vjetorë.
- Të rendisin organet e bimës.
- Të shpjegojnë funksionet e gjethes.
- Të klasifikojnë llojet e gjetheve.
- Të shpjegojnë mënyrat e riprodhimit të bimëve.
- Të përshkruajnë ndërtimin e lules gjimnosperm.
- Të përshkruajnë ndërtimin e lules angiosperm.
- Të përshkruajnë dhe të shpjegojnë pjalmimin e lules.
- Të listojnë tipet e frutave.
- Të shpjegojnë procesin e fotosintezës.
- Të shpjegojnë procesin e frymëmarrjes.
- Të shpjegojnë rënien e gjetheve dhe degëve.
- Të përshkruajnë grupet kryesore të botës bimore.
- Të shpjegojnë lëvizjet në bimë (Fototropizmat)
- Të dallojnë bakteriet ,algat dhe kërpudhat.
- Të argumentojnë evolucionin e bimëve me farë.
- Të përshkruajnë bimët gjimnosperm dhe angiosperm.
- Të shpjegojnë evolucionin e njëthelborëve.

### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Botanikë dhe fiziologji e bimëve”. Kl.10 – 72 orë.

<b>Tema 1</b>	Objekti i botanikës, ndarjet e saj	1 orë
<b>Tema 2</b>	Teoria qelizore, komponentet përbërës dhe ndarja e qelizës.	4 orë
<b>Tema 3</b>	Indet bimore dhe klasifikimi tyre	3 orë
<b>Tema 4</b>	Funksionet e rrënjës, morfologjia dhe metamorfoza e rrënjës.	2 orë
<b>Tema 5</b>	Ndërtimi anatomik i kërcellit, funksionet dhe tipet e tij.	6 orë
<b>Tema 6</b>	Ndërtimi anatomik i gjethes, funksionet dhe klasifikimi i saj	3 orë
<b>Tema 7</b>	Riprodhimi, riprodhimi vegjetativ seksual.	2 orë
<b>Tema 8</b>	Morfologjia dhe funksionet e lules	5 orë
<b>Tema 9</b>	Fruti dhe fara, pjalmimi dhe pllenimi natyral dhe artificial	5 orë
<b>Tema 10</b>	Fiziologjia e këmbimit të lëndëve dhe energjisë, fotosinteza	9 orë
<b>Tema 11</b>	Fiziologjia e zhvillimit. Fitotropizmat dhe procesi i rënies së gjetheve	3 orë
<b>Tema 12</b>	Fiziologjia e lëvizjeve, lëvizjet në bimë. Tropizmat	2 orë
<b>Tema 13</b>	Objekti i sistematikës, grupet sistematike.	2 orë
<b>Tema 14</b>	Bimët e ulta, karakteristikat dhe llojet e tyre	4 orë

<b>Tema 15</b>	Bimët e larta, llojet dhe ndërtimi i tyre	2 orë
<b>Tema 16</b>	Aspekte filogjenetike dhe evolutive të bimëve me farë.	2 orë
<b>Tema 17</b>	Angiospermët, bimët me farë të veshur	7 orë
<b>Tema 18</b>	Pozicioni evolutiv i njëciklikeve dhe aciklikeve	4 orë
<b>Tema 19</b>	Pozicioni evolutiv dhe taksonometrik i petelngjiturave.	2 orë
<b>Tema 20</b>	Aspekte filogjenetike anatomike –morfologjike të njëthelborëve.	4 orë

### 3. Lënda “Pedologji pyjore”( L-25-138-09), Kl. 10 - 36 orë

- **Synimet e lëndës “Pedologji pyjore”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “**Pedologji pyjore**”, **klasa 10**, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e lëndës ”Pedologji pyjore”.
- Të përshkruajnë përbërjen kimike të tokës.
- Të shpjegojnë faktorët që formojnë tokën.
- Të interpretojnë rezultatet e analizës tektonike.
- Të përshkruajnë formën e bimësisë në tokë.
- Të përshkruajnë format e ujit në tokë.
- Të argumentojnë përbërjen e ajrit në tokë.
- Të përshkruajnë cilësitë e tokës.
- Të paraqesin masat për përmirësimin e tokës.
- Të përshkruajnë reaksionet në tokë.
- Të përshkruajnë nevojat e bimëve për NPK.
- Të përshkruajnë plehërat minerale.
- Të përkufizojnë cilësitë fizike-mekanike të tokës.
- Të përshkruajnë morfologjinë e tokës.
- Të kryejnë hapjen e profilit.
- Të klasifikojnë tokat e Shqipërisë.
- Të paraqesin shtrirjen e tokave në vendin tonë.
- Të përshkruajnë llojet e tokave në vendin tonë.
- Të përshkruajnë kushtet e formimit të tokave në vendin tonë

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pedologji pyjore”, kl 10 - 36 orë**

<b>Tema 1</b>	Toka si vendndodhje e bimësisë, përbërja mineralogjike e tokës	2 orë
<b>Tema 2</b>	Proceset e shndërrimit të mineraleve e shkëmbinjëve, formacionet e shkriфта	3 orë
<b>Tema 3</b>	Formimi i tokës.Roli i shkëmbit amnor, klimës, bimëve, relievit, veprimtaria e njeriut.	3 orë
<b>Tema 4</b>	Tekstura dhe struktura e tokës, gjeneza elementare. Faktorët e prishjes dhe ripërtëritjes se tokës.	3 orë
<b>Tema 5</b>	Lënda organike dhe shndërrimet e saj.	2 orë
<b>Tema 6</b>	Uji dhe cilësitë ujore të tokës.Rëndësia e ujit,format e ujit në tokë.	3 orë
<b>Tema 7</b>	Ajri në tokë dhe temperatura e ajrit si faktor pedologjik.	2 orë
<b>Tema 8</b>	Cilësitë e tokës lidhur me ushqyerjen e bimës.Përbërja ,aftësitë thithëse të tokës,format e aciditetit.	5 orë
<b>Tema 9</b>	Plehrat minerale, kërkesat bimore për N.P.K	2 orë

<b>Tema 10</b>	Cilësitë fiziko- mekanike të tokës.	2 orë
<b>Tema 11</b>	Morfologjia e tokës, ndërtimi i profilit, studimet fushore.	2 orë
<b>Tema 12</b>	Tokat e Shqipërisë, klasifikimi, zonaliteti i tyre	7 orë

#### 4. Lënda “Mekanizim pyjor ”( L-25-139-17). Kl. 10 – 36 orë

- **Synimet e lëndës “Mekanizim pyjor”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “**Mekanizim pyjor.**”, **klasa 10**, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë detalet e makinave, akset, boshtet, mbajteset dhe funksionet e tyre.
- Të klasifikojnë tipet e xhuntove dhe funksionin e tyre.
- Të rendisin llojet e lidhjeve të detaleve të makinave dhe funksionin e tyre.
- Të dallojnë llojet e trasmesioneve me rrip, ingranazhe, yllëza, fërkim dhe përdorimi i tyre.
- Të tregojnë ndërtimin dhe funksionin e motorave me djegie të brëndshme, si dhe mekanizmat përbërës të tij.
- Të përshkruajnë mjetet e thjeshta dhe mekanizmat që përdoren në prerjen, rrëzimin dhe përpunimin e pjesshëm të drurit.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionin e motosharrave që përdoren sot .
- Të përshkruajnë pajisjet që përdoren për transportin e lëndës së drurit.(Motoorganot)
- Të rendisin tipet e traktorëve, ndërtimin dhe funksionin e tyre.
- Të përshkruajnë pajisjet dhe mjetet lidhëse, që përdoren gjatë transportit të materialit drunor.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mekanizim pyjor ”, kl 10 - 36 orë**

<b>Tema 1</b>	Detalet dhe nyjet e makinave.	4 orë
<b>Tema 2</b>	Lidhjet e detaleve të makinave.	4 orë
<b>Tema 3</b>	Trasmesionet.	4 ore
<b>Tema 4</b>	Motorët me djegie të brëndëshme.	4 orë
<b>Tema 5</b>	Mjetet e thjeshta dhe mekanizmat që përdoren për prerje, rrëzim përpunim të pjesshëm të drurit	5 orë
<b>Tema 6</b>	Njohuri të përgjithshme për motosharrat.	4 ore
<b>Tema 7</b>	Pajisjet që përdoren për transportin e lëndës drusore.(motoorganot)	5 ore
<b>Tema 8</b>	Traktorët pyjorë dhe mjetet lidhëse.	6 ore

#### 5. Lënda “Dendrologji”, (L-25-140-17), Kl. 10 – 72 orë

- **Synimet e lëndës “Dendrologji”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “**Dendrologji**”, **klasa 10**, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë terminologjinë e fjalës Dendrologji.
- Të përcaktojnë objektin dhe rëndësinë e kësaj shkence.
- Të përcaktojnë faktorët ekologjik dhe zonat fitoklimatike
- Të përshkruajnë karakteristikat morfologjike të drurëve dhe shkurreve të bimëve farëzhveshura.
- Të përshkruajnë karakteristikat morfologjike të drurëve dhe shkurreve të bimëve farëveshura.

- Të përcaktojnë zonat fitoklimatike ku rriten dhe zhvillohen drurët dhe shkurret.
- Të shkruajnë dhe të lexojnë emrat shkencorë të drurëve dhe shkurreve.
- Të shpjegojnë kërkesat që kanë llojet pyjore për klimën dhe tokën.
- Të përcaktojnë llojet e bimëve mjeksore e industriale.
- Të përcaktojnë kohën e grumbullimit, mënyrat e ruajtjes dhe manipulimit të prodhimit të bimëve mjekësore dhe industriale.
- Të përcaktojnë vlerat e tyre dhe rëndësinë e bimëve mjekësore dhe industriale.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Dendrologji”, kl 10 - 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Objekti dhe rëndësia e dendrologjisë	1 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri për ekologjinë pyjore	2 orë
<b>Tema 3</b>	Bimët pyjore farëzhveshura	14 orë
<b>Tema 4</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:shelgore,arrose,mështekore	10 orë
<b>Tema 5</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:ahore,vidhore,trendafilore	15 orë
<b>Tema 6</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:bishtajore,panjore,blinore	9 orë
<b>Tema 7</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:ullinjore,dhe të tjera familje	17 ore
<b>Tema 8</b>	Bimet mjeksore e industriale	4 ore

**6. Lënda “Sistemime malore”( L-25-141-09) Kl. 10 – 36 orë.**

• **Synimet e lëndës ”Sistemime malore”, kl. 10 - 36 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “**Sistemime malore**” në kl.10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë faktorët që ndikojnë në gërryerjen e tokës.
- Të tregojnë faktorët e drejtpërdrejtë me veprim shkatërrues.
- Të shpjegojnë ndikimin e faktorëve klimatikë në dukuritë e degradimit.
- Të klasifikojnë tipet e shkëmbinjëve.
- Të përshkruajnë strukturat e tokës.
- Të tregojnë rolin e faktorit biologjik.
- Të klasifikojnë dukuritë e shkaktuara nga erozioni.
- Të dallojnë erozionin në sipërfaqe nga erozioni linear sipërfaqësor.
- Të shpjegojnë dukuritë e fundosjeve, përmytjeve dhe rrëshqitjeve të shkëmbinjve
- Të përshkruajnë pjesët morfologjike të përroit.
- Të shpjegojnë funksionin e pellgut ujëmladhës.
- Të vlerësojnë rolin e kanalit të rrjedhjes dhe konusit të grumbullimit.
- Të shpjegojnë ndikimin e nivelit bazë mbi evolucionin e formacioneve torrenciale.
- Të shpjegojnë qëllimin e punimeve hidroteknike të kombinuara me punime silvikulturore.
- Të përshkruajnë pritat malore vijëdrejtë me muraturë llaç- çimento.
- Të përshkruajnë përbërjen e trupit të pritës.
- Të tregojnë rolin e kundrapritës dhe shpërndarësit të energjisë.
- Të shpjegojnë rolin e mureve drejtuese dhe të dhëmbit të fundit.
- Të përshkruajnë mënyrën e piktimit të pritës.
- Të dallojnë pragjet prej guri dhe pritat me gabiona.
- Të ndërtojnë prita me gabiona.
- Të përshkruajnë ndërtimin e fashinave dhe funksionin e tyre.
- Të rendisin masat e mbrojtjes kundër shëmbjeve dhe rrëshqitjeve.
- Të planifikojnë organizimin e punimeve në sistemimet malore.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Sistemime malore”, kl. 10 -36 orë**

<b>Tema 1</b>	Faktorët që ndikojnë në gryerjen e tokës	5 orë
<b>Tema 2</b>	Format e ndryshme të degradimit të tokës.	5 orë
<b>Tema 3</b>	Rrjedhjet ujore të rrëmbyeshme, pjesët morfologjike	6 orë
<b>Tema 4</b>	Masat mbrojtëse nga gryerjet	14 orë
<b>Tema 5</b>	Masat kundër shëmbjeve dhe rrëshqitjeve	2 orë
<b>Tema 6</b>	Organizimi i punimeve në sistemimet malore.	4 orë

## **7. Lënda “Fidanishte pyjore”, (L-25-142-09) Kl. 10 - 72 orë.**

- **Synimet e lëndës “Fidanishte pyjore”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “**Fidanishte pyjore.**”, kl 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë riprodhimin e bimëve.
- Të përshkruajnë klimën e vendit tonë.
- Të përshkruajnë zonat bimore të vendit tonë.
- Të përshkruajnë grumbujt farorë.
- Të shpjegojnë fenomenin e periodicitetit.
- Të zgjedhin kohën e përshtatshme për mbledhjen e farërave të pjekura.
- Të rendisin hapat e punët për mbledhjen e farërave.
- Të përcaktojnë treguesit cilësorë të farës.
- Të shpjegojnë vlerën kulturore të farës.
- Të shpjegojnë shpejtimin e mbirjes së farërave.
- Të përcaktojnë kriteret e zgjedhjes së vendit për fidanishte.
- Të zbatojnë mbjelljet e farërave në fidanishte.
- Të llogarisin normën e mbjelljes së farës.
- Të përshkruajnë shërbimet pas mbjelljes së farës.
- Të shpjegojnë shpërnguljen e fidanave.
- Të përshkruajnë prodhimin e fidanave me kalem.
- Të zbatojnë standardet e prodhimit të fidanave.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Fidanishtet pyjore”, kl 10 - 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Pylli si burim i prodhimit të lëndës së drurit	7 orë
<b>Tema 2</b>	Klasifikimi dhe zgjedhja e drurëve	7 orë
<b>Tema 3</b>	Klasifikimi dhe zgjedhja e grumbujve farorë	7 orë
<b>Tema 4</b>	Treguesit cilësorë e sasiore të farërave	10 orë
<b>Tema 5</b>	Veçoritë e mbjelles së farërave	5 orë
<b>Tema 6</b>	Veçoritë e përgjithshme të fidanishteve pyjore	3 orë
<b>Tema 7</b>	Kriteret dhe procedurat e mbjelljes së farërave në fidanishte.	28 orë
<b>Tema 8</b>	Prodhimi i fidaneve me kalem.	3 orë
<b>Tema 9</b>	Standardet e prodhimit të fidaneve.	2 orë

## 8. Lënda "Biologji e kafshëve të pyllit", (L-25-143-09), Kl. 11-34 orë

- **Synimet e lëndës "Biologji e kafshëve të pyllit" , kl. 11- 34 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Biologji e kafshëve të pyllit", kl. 11, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të gjuetisë.
- Të listojnë kafshët e pyllit (me gëzof) rrëmbyes.
- Të listojnë kafshët e pyllit (me gëzof) jorrëmbyes.
- Të theksojnë kriteret për klasifikimin e kafshëve të pyllit.
- Të dallojnë kafshët e pyllit (shpendët) të dëmshëm, grabitqarë dhe jograbitqarë.
- Të rendisin faktorët që rrisin fondin e gjuetisë në vendin tonë.
- Të përcaktojnë mjetet dhe armët e gjuetisë.
- Të rendisin masat që merren për zbatimin e legjislacionit të gjuetisë për shtimin e shumëllojshmërisë së faunës së vendit tonë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Biologjia e kafshëve të pyllit", kl. 11-34 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për kafshët e pyllit	2 orë
<b>Tema 2</b>	Biologjia e gjitarëve rrëmbyes dhe jorrëmbyes	13 orë
<b>Tema 3</b>	Biologjia e shpendëve rrëmbyes e jo rrëmbyes	9 orë
<b>Tema 4</b>	Legjislacioni i gjuetisë	2 orë
<b>Tema 5</b>	Armët e gjuetisë	4 orë
<b>Tema 6</b>	Mjetet e gjuetisë	4 orë

## 9. Lënda "Studim i drurit", (L-25-144-17), Kl. 11 - 34 orë.

- **Synimet e lëndës "Studim i drurit", kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Studim i drurit" në kl. 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e drurëve pyjorë.
- Të përcaktojnë pjesët e drurit dhe përshkruajnë funksionin biologjik të tyre.
- Të përshkruajnë strukturën e trungut dhe karakteristikat e tij nga pamja e jashtme.
- Të dallojnë elementet e strukturës makroskopike të drurit.
- Të dallojnë dhe vizatojnë prerjet bazë të drurit.
- Të shpjegojnë funksionin e elementeve të strukturës makroskopike të drurit dhe të përshkruajnë secilën prej tyre.
- Të përcaktojnë faktorët që ndikojnë në formimin e drurit pyjor.
- Të shpjegojnë mënyrën e formimit të masës drusore.
- Të analizojnë strukturën makroskopike të blanës,myjës,unazave vjetore, poreve dhe kanaleve të rrëshirës
- Të analizojnë strukturën miroskopike të drurit.
- Të shpjegojnë funksionet e secilit element të strukturës miroskopike të drurit.
- Të përshkruajnë difektet e drurit dhe t'i klasifikojnë ato.
- Të listojnë llojet e drurëve kryesorë të vendit tonë sipas karakteristikave dhe fushës së përdorimit.
- Të përshkruajnë rëndësinë vetitë fizike dhe përdorimet e drurit.
- Të përshkruajnë vetitë mekanike, ndikimin e tyre në përdorimin e drurit.
- Të përshkruajnë përbërjen kimike të drurit dhe rëndësinë e secilit përbërës në dru .



- \_ Të shpjegojnë procesin e formimit të fotosintezës në dru .
- Të klasifikojnë përbërësit kimike kryesore të drurit.
- Të tregojnë ndikimin e lagështirës në vetitë e drurit.
- Të listojnë faktorët që ndikojnë në qëndrueshmëri e drurit.
- Të tregojnë rëndësinë e ruajtjes së drurit .
- Të listojnë mënyrat e ruajtjes së drurit të rrëzuar dhe antiseptiket që përdoren

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Studim i drurit”, kl. 11 -34 orë**

<b>Tema 1</b>	Rëndësia e studimit të drurit	4 orë
<b>Tema 2</b>	Studimi makroskopik i drurit	7 orë
<b>Tema 3</b>	Studimi mikroskopik i drurit	6 orë
<b>Tema 4</b>	Difektet kryesore të drurit	4 orë
<b>Tema 5</b>	Vetitë fizike të drurit	6 orë
<b>Tema 6</b>	Vetite kimike e drurit	2 orë
<b>Tema 7</b>	Vetitë mekanike të drurit	2 orë
<b>Tema 8</b>	Qëndrueshmëria, ruajtja ngjyrosja dhe imprenjimi i drurit	3 ore

**10. Lënda “Rrugët pyjore”, (L-25-145-17), Kl. 11 - 34 orë.**

• **Synimet e lëndës “Rrugët pyjore “, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “**Rrugët pyjore**“, kl. 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë terminologjinë dhe konceptet bazë për mbritshmëri në pyje.
- Të shpjegojnë mjetet dhe mekanizmat për të realizuar mbritshmëri pyjore.
- Të shpjegojnë lidhjen midis rrugëve auto dhe mjeteve të transportit për vjeljen e produkteve pyjore.
- Të ilustrojnë me pamje mbritshmërinë në pyje .
- Të shpjegojnë konceptin teorik dhe matjen e shkallës së mbritshmërisë në pyje
- Të rendisin parimet dhe metodat e planifikimit të mbritshmërisë në pyje .
- Të rendisin shembuj praktikë të mbritshmërisë në grumbuj të ndryshëm pyjore .
- Të shpjegojnë ndikimin mjedisor, të rrugëve auto në pyje.
- Të rendisin kategorizimin e shërbimit të pyllit nga rrugët automobilistike.
- Të shpjegojnë konceptin e dendësisë optimale në shtrirjen e rrugës automobilistike.
- Të rendisin faktorët që ndikojnë në zgjidhjet tekniko-ekonomike për optimizimin e rrjeteve rrugore pyjore
- Të llogarisin vëllimin e trupit të rrugës pyjore.
- Të përshkruajnë elementet përbërës të rrugëve dhe kategorizimin e rrugëve auto .
- Të shpjegojnë parimet bazë të studimit dhe projektimit të rrugëve auto -pyjore
- Të shpjegojnë ne hartë trasimin e një boshti rrugë në hartë
- Të rendisin instrumentat që përdoren në trasimin e rrugës në terren.
- Të përshkruajnë mënyrën e trasimit të rrugës auto pyjore
- Të rendisin punimet përgatitore dhe ndihmëse për ndërtimin e veprës rrugore.
- Të përshkruajnë punimet për ndërtimin dhe gërryerjen e veprës rrugore
- Të rendisin mjetet dhe mekanizmat për punimin e rrugës.
- Të shpjegojnë teknikën e ndërtimit të kurorës rrugore



• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Rrugët pyjore“, Kl. 11 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Mbritshmëria e pyjeve qëllimi dhe detyrat kryesore.	4 orë
<b>Tema 2</b>	Planifikimi i mbritshmërisë së pyjeve.	4 orë
<b>Tema 3</b>	Optimizimi i shtrirjes së rrugëve auto në pyje	8 orë
<b>Tema 4</b>	Studimi dhe projektimi i rrugëve auto - pyjore	7 orë
<b>Tema 5</b>	Ndërtimi i rrugëve auto -pyjore	11 orë

**11. Lënda “Silvikulturë“, (L-25-146-17), Kl .11-68 orë**

• **Synimet e lëndës “Silvikulturë”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës ”Silvikulturë”, kl. 11, nxënësit duhet :

- Të tregojnë se cili është objekti dhe qëllimi i shkencës së silvikulturës, si dhe rëndësinë e saj si degë prodhimi.
- Të tregojnë se silvikultura nuk ka lindur e shkëputur nga shkencat e tjera pyjore dhe nuk zhvillohet e shkëputur prej tyre.
- Të përcaktojnë elementët përbërës të pyllit dhe ndikimin reciprok ndërmjet tyre.
- Të dallojnë ndryshimet morfologjike dhe fiziologjike ndërmjet drurëve të rritur në pyll dhe atyre të vetmuar.
- Të përcaktojnë katet e bimësisë së pyllit, karakteristikat e drunishtes dhe rolin parësor të saj në jetën e pyllit.
- Të klasifikojnë grumbujt pyjorë mbi bazën e origjinës dhe prejardhjes .
- Të përcaktojnë karakteristikat e kateve të tjera si të nëndrunishtes, filizërisë e shtresës barishtore.
- Të përcaktojnë faktorët ekologjik.
- Të shpjegojnë rolin e dritës, nxehtësisë, lagështisë në jetën e pyllit.
- Të klasifikojnë drurët sipas kërkesave që kanë për dritë, nxehtësi dhe lagështi.
- Të shpjegojnë ndikimin e pyllit me karakteristikat e tij në intensitetin e dritës, nxehtësisë dhe lagështisë në mbrendësi të pyllit.
- Të shpjegojnë ndikimin e tokës në jetën e drurëve të pyllit.
- Të përcaktojnë elementët e faktorit biotik.
- Të përcaktojnë llojet e ripërtëritjes së pyllit.
- Të përcaktojnë formacionet pyjore kryesore në vendin tonë

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës ”Silvikulturë”, kl. 11 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Silvobiologjia	3 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri të përgjithshme mbi pyllin	5 orë
<b>Tema 3</b>	Drunishtja, karakteristikat e saj	11 orë
<b>Tema 4</b>	N/drunishtja, filizëria dhe shtesa barishtore	5 orë
<b>Tema 5</b>	Raportet ndërmjet pyllit dhe mjedisit rrethues	2 orë
<b>Tema 6</b>	Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit klimatik	17 orë
<b>Tema 7</b>	Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit toksorë	6 orë
<b>Tema 8</b>	Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit reliev dhe atij biotik	6 orë
<b>Tema 9</b>	Ripërtëritja, rritja dhe zhvillimi i pyllit	8 orë
<b>Tema 10</b>	Shpërndarja e bimësisë pyjore dhe klasifikimi i pyjeve	5 orë

## 12. Lënda “Dendrometri“, (L-25-147-09), Kl. 11 - 68 orë

### • Synimet e lëndës “Dendrometri“, kl.11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Dendrometri” në kl. 11, nxënësit duhet :

- Të përcaktojnë karakteristikat dendrometrike të grumbujve pyjorë.
- Të përcaktojnë formën dhe vëllimin e trupit.
- Të tregojnë veglat matëse për matjen e gjatësive, trashësive dhe lartësive.
- Të zbatojnë rregullat e matjes në diametër ,gjatësi dhe lartësi.
- Të përdorin instrumentat matës.
- Të përcaktojnë faktorin e kubimit me metoda të ndryshme.
- Të përcaktojnë koeficientin e formës.
- Të përcaktojnë vëllimin e drurit në këmbë me mënyra të ndryshme.
- Të përcaktojnë diametrin mesatar dhe lartësinë mesatare në mënyra të ndryshme.
- Të përshkruajnë inventarizimin e përgjithshëm dhe të pjesshëm.
- Të zbatojnë metodat e kubimit në grumbuj të ndryshëm pyjorë.
- Të përcaktojnë moshën e drurit dhe të grumbullit.
- Të përcaktojnë pasqyrat e prodhimit në grumbujt pyjorë.
- Të përcaktojnë rritjet në grumbuj pyjorë.

### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Dendrometri”, Kl. 11- 68 orë

<b>Tema 1</b>	Objekti dhe zhvillimi i matjes së drurëve	1 orë
<b>Tema 2</b>	Pjesët përbërëse të drurit dhe elementë të tij	2 orë
<b>Tema 3</b>	Instrumentat matës	8 orë
<b>Tema 4</b>	Kubimi i drurit të rrëzuar	12 orë
<b>Tema 5</b>	Kubimi i drurit në këmbë	7 orë
<b>Tema 6</b>	Karakteristikat e grumbujve pyjorë	8 orë
<b>Tema 7</b>	Kubimi i grumbujve pyjorë	11 orë
<b>Tema 8</b>	Inventarizimi i grumbujve pyjorë	10 orë
<b>Tema 9</b>	Studimi i rritjeve në drurët dhe grumbujt e pyjeve	8 orë
<b>Tema 10</b>	Ligjet e rritjeve të drurëve	1 orë

## 13. Lënda “Mbrojtja e pyjeve“ (L-25-452-17), kl. 11-34 orë

### • Synimet e lëndës “Mbrojtja e pyjeve“, kl.11 -34 orë.

Në përfundim të lëndës “Mbrojtja e pyjeve “ “ në kl. 11, nxënësit duhet :

- Të përcaktojnë masat që duhen marrë për të mbrojtur pyjet nga kushtet e këqija stacionale.
- Të përcaktojnë llojet e zjarreve në pyje.
- Të identifikojnë periudhat e rënies së zjarreve.
- Të përcaktojnë masat për parandalimin e zjarreve.
- Të listojnë disa sëmundje të pyjeve.
- Të përshkruajnë dëmin si dhe masat e luftimit.

- Të përshkruajnë insektet dëmtues të halorëve dhe fletorëve.
- Të përshkruajnë insektet dëmtues të fidanishtes.
- Të zbatojnë masat që merren për luftimin e sëmundjeve të pyjeve
- Të zbatojnë metoda të ndryshme për ruajtjen e pyjeve.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtja e pyjeve”, kl. 11-34 orë**

<b>Tema 1</b>	Objekti dhe rëndësia e mbrojtjes së pyjeve .	1 orë
<b>Tema 2</b>	Mbrojtja e pyjeve nga dëmtimet që shkaktojnë kushtet e këqija stacionale të klimës dhe të tokës	2 orë
<b>Tema 3</b>	Zjarret në pyje, llojet, masat për parandalimin e tyre .	2 orë
<b>Tema 4</b>	Njohuri mbi sëmundjet në pyje. Fitopatologjia pyjore	14 orë
<b>Tema 5</b>	Entomologjia pyjore. Dëmtuesit primarë dhe sekondare të pyjeve	12 orë
<b>Tema 6</b>	Metodat e mbrojtjes së pyjeve	3 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Proceset e punës në fidanishte”

Drejtimi: Pyje

Niveli: I

Klasa: 10

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PROCESET E PUNËS NË FIDANISHTE	M-25-347-09
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune në fidanishte me vegla të thjeshta.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përgatit tokën për mbjelljen e farës.</b> <b><i>Përmbajtja:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Interpretimi i kriterëve të përzgjedhjes së sipërfaqes për pyllëzim</li><li>– Përzgjedhja e parcelës sipas kriterëve të përcaktuara më parë.</li><li>– Përcaktimi i radhës së punës për sistemimin e parcelës (me krah, makineri)</li><li>– Llogaritja e largësive të gropave</li><li>– Piketimi i vendit të hapjes së gropës sipas largësive të kërkuara</li><li>– Përcaktimi i përmasave të hapjes së gropave</li><li>– Hapja e gropës për mbjelljen e fidanëve pyjorë sipas standardit të kërkuar.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për mbjelljen e farës</li></ul> <b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b><i>Kriteret e realizimit:</i></b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të interpretojë kriteret e përzgjedhjes së sipërfaqes për pyllëzim</li><li>– të përzgjedhë parcelën sipas kriterëve të përcaktuara më parë.</li><li>– të përcaktojë radhën e punës për sistemimin e parcelës (me krah, makineri)</li><li>– të llogaritë largësitë e gropave</li></ul>	

- të piketojë vendin e hapjes së gropës sipas largësive të kërkuara
- të përcaktojë përmasat e hapjes së gropave
- të hapë gropën për mbjelljen e fidanëve pyjorë sipas standardit të kërkuar.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për mbjelljen e farës.

## **RM 2 Nxënësi mbjell farën**

### ***Përmbajtja***

- Zgjedhja e plehut për dherishte.
- Zgjedhja e dheut.
- Kryerja e plehërimit organik sipas sasisë dhe llojit të përcaktuar më parë në bazë të analizave të tokës.
- Përzierja e e sasisë së plehut organik me shtresat e fundme të gropës .
- Zgjedhja e qeskave.
- Mbushja e qeskave me dherishte.
- Mbjellja e farës.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë plehun për dherishte
- të zgjedhë dheun
- të kryejë plehërimin organik sipas sasisë dhe llojit të përcaktuar më parë në bazë të analizave të tokës.
- të përziejë sasinë së plehut organik me shtresat e fundme të gropës .
- të për zgjedhë qeskat e duhura.
- të bëjë mbushjen e qeskave me dherishte.
- të bëjë mbjelljen e farës.

## **RM 3 Nxënësi kryen shërbime pas mbjelljes**

### ***Përmbajtja***

- Tharja e barërave.
- Mbulimi i farave.
- Ujitja e qeskave.
- Mbrojtja e farave nga brejtësit.
- Spërkatja e bimëve për t'i mbrojtur nga sëmundjet.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve pas mbjelljes.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë tharjen e barërave
- të kryejë mbulimin e farave
- të ujisë qeskat

- të demonstrojë metoda për mbrojtjen e farave nga brejtësit
- të kryejë spërkatjen e bimëve për t'i mbrojtur nga sëmundjet
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve pas mbjelljes.

**RM 4 Nxënësi kryen shërbime të tjera pas mbjelljes së farërave**  
***Përmbajtja***

- Mbulimi i bimëve për t'i mbrojtur nga ngricat.
- Ujitja e bimëve
- Thyerja e kores së tokës.
- Shkriftimi i tokës.
- Rrallimi i bimëve.
- Spërkatja e bimëve
- Formimi i kurorës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të tjera pas mbjelljes .

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbulojë bimët për t'i mbrojtur nga ngricat.
- të ujitë bimët
- të kryejë thyerjen e kores së tokës.
- të kryejë shkriftimin e tokës.
- të kryejë rrallimin e bimëve.
- të spërkatë bimët
- të formojë kurorën
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të tjera pas mbjelljes

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantët profesionale në parcelën pranë shkollës, në ferma bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës në fidanishte. Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për mbjelljen e farave në fidanishte fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës në fidanishte. Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në fidanishte.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Parcelë për kryerjen e praktikës
  - Vegla te thjeshta të dorës si: kazma, bel, shat, cfurqe, krehëra etj
  - Tezga.
  - Karroca dore.
  - Uniforma e punës
  - Katalogje
  - Manuale bujqësore e blegtorale
-

## 2. Moduli “Punime në pyllëzimet artificiale”

Drejtimi: Pyje

Niveli: I

Klasa: 10

